




**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL VI/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (gjashtë) për vitin 2026 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.06.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Merita Basha

z.Zek Berisha

znj.Amira Sofra

z.Aziz Bytyqi

z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonus banimit ;**

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

4. Të ndryshme;

Kryesuesja-e hedhë në votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara

Kryesuesja- e hedhë në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonus banimit ;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë,Komuna jon e ka bërë tradicionale çështjen e bonus banimit për të gjithë ata qytetarë të cilët kanë nevojë,mirpo në krahasim nga e kaluara këtë vit ka ndryshuar ligji për çështjen e financimit për bonus banim,minimumi dhe maksimumi i subvencionimit të qeras për familjet në nevojë është 50%,dhe kërkohet që sipas ligjit të përcaktohet edhe vlera financiare sa buxhet ka të planifikuar Komuna e Suharekës për këtë vit që të ndihmojë familjet në nevojë për çështjen e banimit të banesave apo shtëpive private që i marrin nga qiradhënsi.Në konsultim me Kryetarin e Komunës kemi bisedu që në këtë vit të vazhdohet me 15 familje vlera e përgjithshme dikun 25.000€ vjetore,procedurat janë ashtu siq kanë qenë në të kaluarën.

Urim Suka-përshendetje për të gjithë,ajo që unë po du me pas një farë lloji pasqyre pak më të qartë na ka mungu raporti për vitin paraprak,dhe është mirë që ne me pas raportin me ditë sa ka pas kërkesa, sa kanë përfitu,sa kanë aplikuar,sa janë refuzuar kur e kemi një pasqyre se çka ka ndodhur në vitin paraprak e kemi shumë më të qartë me planifikuar sa më mirë për të ardhmen.Unë deshta me diskutu punën e kriterëve në bazë të ligjit përcaktohen disa kriterë p.sh te pika parë është familjet apo individët me gjendje jo të mirë ekonomike apo përfitues të asistencës sociale,ai e merr një vendim ku merr shtet dhe mundet me dëshmuar por kur thojmë individët me gjendje jo të mirë ekonomike kush e përcakton këtë gjendje jo të mirë ekonomike qfarë dokumente sjellë? Dhe e dyta familje e madhe me shumë fëmijë ndoshta mundet me kanë familje e madhe por mundet me i pas kushtet shumë të mira.

Avni Bytyçi-edhe në KPF e kanë kërkuar raportin dhe po besojë që nesër kanë me sjellë dhe është kërkesë plotësisht e drejtë.

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyçi-janë dy kërkesa nga Kedsit për vendosjen e trafos në dy lokacione dhe ne e kemi zbatuar dhe ju kemi dhënë mundësi edhe për Kedsin dhe qytetarët që ta caktojmë lokacionin dhe kemi nda ka 4m² për dy lokacione me qëllim që ti krijojmë kushte sa më të mira qytetarëve për çështjen e furnizimit me energji elektrike.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi:9:20